

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“KADRIU” Shpk

Ortakët themelues:

Kavaje 07.08.2023

1. **Halit Kadriu** lindur dhe banues ne Kosove me Nr. Pashaporte P00921472.

Bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar), sot më datë 07.08.2023 harton këtë Akt Themelimi të shoqërisë tregtare si më poshtë vijon;

NENI 1

Emri

1.1 Shoqëria tregtare mban emrin “**KADRIU**”shpk

1.2 Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

NENI 2

Forma

2.1 Shoqëria tregtare “**KADRIU**” shpk, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qendrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**KADRIU**” shpk do të ketë zyrën e saj qendrore në adresën: Kavaje, Qerret, zona kadastrale nr. 3101, pasuria nr. 9/36.

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë

4.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj tregtare ne fushen e ndertimit.

NENI 5

Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë “**KADRIU**”do të jetë me afat të pacaktuar.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

6.1 Shoqëria tregtare “**KADRIU**” shpk mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.



NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

7.1 Ortakët nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë "KADRIU" Shpk dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "KADRIU" Shpk është 100.000 (njqindemije) lekë.

Ortakët e shoqërisë janë:

- 1- Z. **Halit Kadriu** është zotërues i 1 (një) kuote e cila përbën 100 % të kapitalit të shoqërisë.

NENI 9

Organet e Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 10

Administratori

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Ortakë e Shoqërisë. Afati i emërimit është 5(Pese)vjet. Kompetencat e adminsitrorit përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Administrator i Shoqërisë është Z. **Halit Kadriu** lindur ne banues ne Kosove, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr. Pashaporte P00921472.

Ky Akt Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore.

ORTAKËT

E SHOQERISË ME PERGJEGJESI TË KUFIZUAR



"KADRIU" Shpk

HALIT KADRIU

HALIT KADRIU

A stylized handwritten signature in blue ink, consisting of a series of loops and a long horizontal stroke extending to the right.